



Një dijetar e pyeti studentin e tij: Sa vjet u bën që më shoqëron mua?

Studenti: 33 vjet.

Dijetari: Çfarë ke mësuar prej meje gjate kësaj kohe?

Studenti: Kam mësuar tetë gjëra.

Dijetari: Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!- tha i çuditur. Më kaloi jeta me ty ndërsa ti nuk ke mësuar më shumë se tetë gjëra.

Studenti: Nuk kam mësuar tjera dhe nuk dua te gënjejë.

Dijetari: Atëherë m'i thuaj ato tetë gjëra që paske mësuar prej meje!

Studenti:

1. Vrojtova dhe shikova me kujdes në krijesa dhe pashë se secili prej tyre ka nga një te dashur por kur të shkojë te varrezat i dashuri ndahet prej tij/saj, kështu që unë të dashur caktova veprat e mira që kur të hyjë në varr edhe ato të hyjnë me mua.

2. Analizova thënien e Allahut: E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, 41. Xheneti është vendi i tij". (en-Naziat, 40-41), kështu që dhashë mund e derdha energji për ta larguar epshin në mënyrë që shpirti im të përqendrohet në adhurim për Allahun.

3. Pashë se njerëzit që kishin gjera të çmuara dhe me vlere i ruanin ato që të mos humbnin. Pastaj meditova fjalën e Allahun: Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, e ajo që është te All-llahu është e përjetshme...". (en-Nahl, 96), kështu që sa herë që në dorën time binte

ndonjë e mire e drejtoja kah Allahu që të ruhet tek Ai.

4. Shikova në krijesa kur ja pashë se tërë ata mburreshin me pasuri, familje ose prejardhje, pastaj shqyrtova fjalën e Allahut: ...e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), “. (el-Huxhurat, 13), kështu që iu qasa devotshmërisë që të jem i ndershëm tek Allahu.

5. Pashë se njerëzit fyenin dhe mallkonin njëri tjetrin dhe tërë këtë si shkak i zilise-smirës (hasedit). Meditova fjalën e Allahut: ... Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë...”. (ez-Zuhruf, 32), kështu që e braktisa zilinë ngase u binda se ndarja e dhuntive bëhet nga Allahu i Madhëruar.

6. Pashë njerëzit duke u armiqësuar, bërë padrejtësi dhe luftuar njeri tjetrin. Shikova fjalën e Allahut: Djalli është armik i juaji, pra edhe ju konsiderojeni armik...”. (Fatir, 6), kështu që braktisa armiqësinë ndaj njerëzve dhe fillova të ushtroj armiqësinë time vetëm ndaj djallit.

7. Pashë se njerëzit për ta fituar idaren (furnizimin) bënë çdo gjë, madje edhe gjëra të paligjshme. Shikova thënien e Allahut: Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj...”. (Hud, 6), kështu që u binda se unë jam një prej këtyre gjallesave të shumta që Allahu ka përsipër furnizimin e tyre kështu që furnizimin tim që kam tek Ai e lashë (i bindur se do ta arrije atë në mënyrë të ligjshme).

8. Shikova krijesat dhe pashë se secili prej tyre mbështetej në një krijesë të ngjashme me të; ky për pasurinë e tij, ky për gjënë e humbur të tij, ky për shëndetin e tij, ky për qendrën e tij...Pastaj iu referova fjalës së Allahut: ...Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij...”. (et-Talak, 3), kështu që i ika mbështetjes në krijesa dhe punova në drejtim të mbështetjes vetëm në Allahun e Madhëruar!

Mësuesi: Allahu të bekoftë!

Burimi: www.almualem.net

Përshtati në shqip: [Sedat G. ISLAMI](#)